



Komuna e Kaçanikut
Municipality of Kaçanik

Nr. 336, 24.8.2018



Gjimnazi "Skënderbeu" Kaçanik
Gymnasium "Skënderbeu" Kaçanik

KËRKESE OFERTIMI PËR EKSKURSION NË SHQIPËRI

Bazuar në Ligjin Nr.04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 23, dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2016 të 12.01.2016 të MASHT, për Aktivitetet Jashtëshkollore, si dhe me vendimin e DAK për Ekskursionin e Maturantëve në Shqipëri, Drejtoria e Gjimnazit "Skënderbeu" në Kaçanik, shpall:

KËRKESE OFERTIMI PËR EKSKURSION TË MATURANTËVE NË SHQIPËRI

Numri i paraleleve-nxënësve: 9 paralele – 284 nxënës.

Koha e ekskursionit: nga 10.IX.2018 deri më 14.IX.2018 (5 ditë e 4 netë).

Vendi: Shqipëri.

Itinerari:

- Kaçanik-Lezhë-Durrës (vendqëndrimi kryesor);
- Durrës-Vlorë;
- Durrës-qyteti i vjetër;
- Durrës-Tiranë;
- Durrës-Krujë-Kaçanik.

Kompanitë-agjencionet ofertuese duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Licencën;
- Kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
- Numër të mjaftueshëm të autobusëve komforë dhe me klimë, së paku 6 sosh.;
- Dëshmi mjekësore për shëndetin e ngasësve të autobusëve;
- Përkujdesje të vazhdueshme mjekësore për nxënësit (mjeku i diplomuar dhe me certifikatë pune);
- Të ofrojnë mundësi verifikimi paraprak - të drejtëpërdrejtë të kushteve transportuese dhe hoteliere;
- Si dhe kushte të tjera sipas ligjit, që saktësohen në kontratë.

Afati i ofertimit: shtatë ditë - nga 24.8.2018 deri më 30.8.2018.

Materialet tenderuese dorëzohen në objektin e Komunës: çdo ditë pune, në emër të Gjimnazit "Skënderbeu", në Zyrën e Pranimit.

Hapja dhe vlerësimi i ofertave: më 30.8.2018, ora 14 e 30, në objektin e Komunës (në Sallën e Kuvendit).

Kërkesa u publikua: në Tabelën e shpalljeve në Gjimnaz dhe në Uebfaqen e Komunës së Kaçanikut (kk.rks-gov.net/kacanik/).

Drejtori,

Z. Ibush Vishi

